



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SE SHKALLES SE PARË LEZHË

RELACION

(Për analizën vjetore të treguesve të vitit 2016)

Shkurt 2017

Treguesit e punës dhe veprimtarisë së Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së parë Lezhë për vitin 2016, dhe prioritetet për vitin 2017.

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, analizon në këtë raport veprimtarinë e punës të periudhës 1-vjeçare për vitin 2016, gjendjen e kriminalitetit në territorin ku ushtrohet veprimtaria ligjore, pra në juridiksionin që ushtron veprimtarinë e saj, përmbushjen e detyrimeve ligjore si institucion dhe Prokurorëve që përfaqësojnë atë, arrijtjet problemet dhe mangësitë e evidentuara, si dhe përcaktimin e prioritetëve dhe drejttimeve kryesore për përsosjen e mëtejshme të veprimtarisë së saj në të ardhmen.

Gjatë vitit 2016, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë e ka ushtruar veprimtarinë e saj në mbështetje dhe respektim të plotë të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe ato që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe, të ratifikuara me ligj nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ushtrimi i kësaj veprimtarie kushtetuese dhe ligjore, ashtu siç edhe do të analizohet në vijim të këtij raporti, është kryer, bazuar në një angazhim maksimal të të gjithë stafit të kësaj prokurorie, duke ndjekur dhe respektuar me përpikmëri çdo urdhër dhe udhëzim të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, ushtron veprimtarinë e saj të ndjekjes penale, në juridiksionin e dy rretheve administrative Lezhë - Mirditë.

Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, duke shtuar këtu dhe trupën e shërbimeve të Policisë Gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Lezhë, gjatë kësaj periudhe që analizojmë rezulton se i janë përkushtuar punës, duke ju përmbajtur respektimit të ligjit si detyrim parësor, krijuar kushtet dhe rrethanat ligjore të zbatimit të të drejtave të njeriut, për arrijtjen dhe vënien para përgjegjësisë penale të autorëve të kryerjes së veprave penale, por dhe duke zbatuar dhe respektuar të drejtat procedurale ndaj tyre gjatë procesit hetimor.

Gjatë vitit 2016, për përballimin e punës dhe ushtrimin e veprimtarisë, kanë marrë pjesë 9(nente) prokurore, përfshirë drejtuesin dhe zv/drejtuesin, 5-oficerë të policisë gjyqësore dhe 9-punonjës të administratës. Po kështu, për ushtrimin efikas të veprimtarisë së kësaj Prokurorie, një ndihmë dhe bashkëpunim të rëndësishëm kanë dhënë edhe oficerët e policisë gjyqësore të Seksioneve të Policisë pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Lezhë, si dhe oficerët e policisë

gjqësore pranë Komisariateve të Policisë Lezhë dhe Mirditë, të cilët kanë mbajtur edhe një peshë të konsiderueshme në hetimin e çështjeve penale të rregjistruara gjatë këtij viti.

Drejtimi kryesor i punës një vjeçare të kësaj prokurorie ka qenë lufta kundër trafikut të narkotikeve, vepra penale e cila në territorin që ushtron juridiksionin kjo prokurori ka pasur një shtrirje të gjere.

Rezultoni se gjatë kësaj periudhe 1-vjeçare, nga ana e prokurorëve të kësaj prokurorie është ushtruar ndjekja penale dhe janë ndjekur procese gjyqësore në një numër të konsiderueshëm çështjesh penale, të rregjistruara për një larmi të ndryshme veprash penale.

Janë regjistruar (korespondencë) në sekretarinë e Prokurorisë Lezhë, referuar për vepra penale **1593** –materiale për vitin **2016** krahasuar me **1743** - materiale të vitit **2015** pra **150 materiale me shume.**

TREGUESIT E VOLUMIT DHE DINAMIKA E LËVIZJES SË PROCEDIMEVE

Gjatë vitit **2016** në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë u hetuan **1370** procedime , te ndara ne **200** kundravajtje dhe **1170** krime, krahasuar me **1666** të hetuara nga viti **2015**,

Viti 2016

| | | | |
|---------------------------------|------|--------------------------|-----|
| • Mbartur nga vitet e mëparshme | 342 | procedime | (1) |
| • Regjistruar gjatë vitit 2016 | 1008 | procedime | (2) |
| • Rifilluar gjatë vitit 2016 | 20 | procedime | (3) |
| | 1370 | procedime | |
| •Ndarë në procedime më vete | 9 | procedime ne 9 | |
| •Bashkuar | 25 | procedime bashkuar ne 23 | |

Gjatë kësaj periudhe është kryer një volum pune, ne renie në krahasim me një vit më parë pra 2015-ën, si të regjistrimeve të çështjeve penale, dhe një numër me i madh i akteve të referuara për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Më konkretisht janë 530 + (45 mosfillime për vepra penale për të cilat nuk ka pasur kualifikim ligjor, si për shembull largime nga banesa etj.) gjithsej 575 materiale për të cilat është vendosur mosfillimi krahasuar me 554 mosfillime për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit për vitin 2015.

Por treguesit e punës tonë në përgjithësi dhe asaj në veçanti të çdo Prokurori, Oficeri të Policisë Gjyqësore, do ta realizonim duke ju referuar të dhënave statistikore 1-vjeçare që analizojmë pra vitin 2016.

Kanë marrë zgjidhje 1071 procedime nderkohe që u mbarten për vitin 2017, 299 procedime:

Nga 1593 materialet e rregjistruara në sekretarinë e Prokurorisë për vitin 2016, 1322 prej tyre janë referuar nga nga sektorët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Lezhë, përfshi këtu dhe Komisaritet e Policisë Lezhë-Mirditë, Drejtoria e Kufirit Durrës, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ndërsa në vitin 2015 nga 1743 materialet e rregjistruara në sekretarinë e Prokurorisë 1591-të referuara nga sektorët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Lezhë, përfshi këtu dhe

Komisariatet e Policisë Lezhë-Mirditë, Drejtorise Se Kufirit Dures si dhe Drejtorise se Pergjithshme te Policise se Shtetit.

Të gjitha rastet e akteve të referuara apo kallëzimeve të paraqitura janë trajtuar me përgjegjësi, duke i evidentuar në regjistrat përkatës, të regjistrimit të çështjeve apo regjistrin e kallëzimeve (mosfillimeve), duke marrë vendime përkatëse ligjore, regjistrimi apo mosfillimi të çështjes penale, ku në përgjithësi janë respektuar afatet ligjore të vendimarrjes si në rastet e mosfillimit (sipas udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm 30-ditor) dhe ato të regjistrimit sipas urdhërit të përbashkët “Për funksionimin e shërbimeve të Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit”.

Vihet re **një renie** e numrit të procedimeve të regjistruara rishtazi (296 më pak se sa vitin e kaluar). Referimet nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Lezhë (Komisariatit te Policise Lezhe dhe Mirdite) vazhdojnë të mbeten në nivele të larta. Ndërkohë, kanë marrë zgjidhje përfundimtare 1071 procedime, praktikisht numër më i vogël krahasuar me vitin e kaluar (258 procedime). U mbartën për këtë vit 299 procedime.

Nga këto materiale kallëzimi dhe referimi në **530** + (45 mosfillime per vepra penale per te cilat nuk ka pasur kualifikim ligjor, si per shembull largime nga banesa etj.) gjithsej **575 -raste është vendosur mosfillimi i procedimit penal** në bazë të neneve 290-291 të K.Pr.Penale (numër më i madh krahasuar me vitin 2015 që kishte **554-raste mosfillime**, pra 21 raste mosfillime me shume), ndërsa **është vendosur regjistrimi për 1008 - çështje penale** (nga 1199 për vitin 2015) pra 191-çështje të rregjistruara më pak se një vit më parë.

Mendoj se më qartë veprimtaria e Prokurorisë do të rezultonte duke analizuar treguesit sipas dinamikës së vendimarrjes referuar dhe praktikës procedurale që ndiqet, nga momenti i konstatimit të veprave penale nëpërmjet vend-ngjarjeve, kallëzimeve penale etj, që të krijonim një tablo sa më të qartë të rezultateve apo mangësive si dhe problematikave të evidentuara.

2. TREGUESIT TEKNIKË TË ZGJIDHJES SË PROCEDIMEVE NË PËRFUNDIM TË HETIMEVE PARAPRAKE

Ne përfundim te hetimeve per vitin 2016 nga 1370 procedime penale u derguan per gjykim 356 çështje ose (26%), u pushuan 316 çështje ose (23 %), u pezulluan 356 çështje ose (26 %), u transferuan 45 çështje ose (3%), dhe u mbarten 299 çështje ose (22%).

Nisur nga analizimi i te dhenave te mesiperme rezulon se eshte dhene zgjithje per rreth 78 % te procedimeve penale te hetuara per vitin 2016, shifer kjo qe konsiderohet si tregues i mire.

Eshtë vendosur mosfillimi për 575 referime aktesh, e më konkretisht po i pasqyrojmë si më poshtë:

I. MOSFILLIMET (sipas neneve 290-291 të K.Pr.Penale)

Është vendosur mosfillimi i procedimit penal në bazë të neneve 290 dhe 291 të K.Pr.Penale për 575-referime aktesh.

Në numrin 575-të vendimeve të mosfillimit rezultojnë, per veprat penal ne seksionin e krimeve kunder personit (nenet nga 76 i K.Penal – 133 i K.Penal) kemi 244 vendime mosfillimi ku ne pese raste vendimi i mosfillimit eshte ankimuar ne gjykate.

Ne seksionin e veprave penale kunder pasurise dhe ekonomise (nenet 134 i K.Penal – 200 i K.Penal) kemi 146 raste mosfillimi ku ne raste vendimi i mosfillimit eshte ankuar ne gjykate.

Ne seksionin krime kunder mjedisit (nenet 201 i K.Penal – 207 i K.Penal) kemi 2 raste mosfillimi.

Ne seksionin e veprave penale kunder autoritetit te shtetit (nenet 235 i K.Penal – 299 i K.Penal) kemi 155 raste mosfillimi ku ne 4 raste eshte ankimuar ne gjykate vendimi i mosfillimit.

Ne seksionin e krimeve kunder drejtesise (nenet 300 i K.Penal – 324/a i K.Penal) ne 8 raste eshte vendosur mosfillimi, ku ne nje rast vendimi i mosfillimit eshte ankimuar ne Prokurorine e Pergjithshme e cila e ka shfuqizuar vendimin e mosfillimit duke urdheruar prokurine te kryeje hetime te metejshme.

Në rastet e vendimeve te mosfillimit per seksionin e krimeve kunder personit (nenet 76-133) kemi te bejme me se shumti me vepren penale te parahikuar nga neni 90 i K.Penal, e cila ne baze te nenit 59 te K.Pr. Penale ndiqet mbi ankimin e te demtuarit ne gjykate, si dhe me vepren penale te parashikuar nga neni 99 i K.Penal ku pas hetimeve te kryera nuk eshte bere e mundur evidentimi i ndonje elementi te vepres penale te lartpermendur.

Ne seksionin e krimeve kunder mjedisit (nenet 201-207) ke dy raste, peshkim i paligjshem dhe prerje e paligjshme e pyjeve, per te cilat ne perfundim te hetimeve rezultoj se mungonin elementet e vepres penale perkatese, pasi rastet e lartpermendura sipas legjislacionit ne fuqi duhen konsideruar si çeshtje administrative dhe jo penale.

Ne seksionin e krimeve kunder autoritetit te shtetit, (nenet 235- 299) ke 155 raste mosfillimi ku ne kater raste vendimi i mosfillimit eshte ankuar ne gjykate.

Kryesisht vendimet e mosfillimit per seksionin e krimeve kunder autoritetit te shtetit jane marre per veprat penale te parashikuara konkretisht nga nenet 248-289-290 te K.Penal ku pas veerifikimeve te kryera ne kuader te hetimeve nuk eshte bere i mundur evidentimi i elementeve te vepres penale.

Në të gjitha rastet e mosfillimit të çështjeve janë bërë njoftimet e vendimeve të mosfillimit palëve të interesuara gjë që evidentohet si nga korespondenca e shkresës ashtu dhe kopjet e vendimeve të konfirmuara dhe të administruara në fashikujt përkatës.

Duhet evidentuar se numri i mosfillimeve këtë vit rezulton në një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin e fundit, ku në vitin 2015 janë 554-vendime mosfillimi dhe në vitin 2016 jane 575 raste mosfillimi. Evidentojmë faktin se aktet e referuara regjistrohen në regjistër më vete, në momentin e parë sipas vlerësimit të kallëzimit apo referimit.

Nga 575 vendime-mosfillimi, janë ankimuar 11 vendime pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, si dhe 1 vendim ne Prokurorine e Pergjithshme, për të cilat në 1 rast është vendosur prishja e vendimit të mosfillimit të marrë nga Prokurori,dhe rregjistrim i procedimit penal nr. 830 te vitit 2016 për nenin 134 i cili vazhdon të jetë në hetim.

Nga ana e Gjykatës janë prishur dhe këto vendime mosfillimi që janë të viteve të tjera e konkretisht:

1. Mosfillim nr.1622 i vitit 2015, është vendosur prishja nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe është regjistruar procedimi penal.
2. Mosfillim nr. 257 i vitit 2016, është vendosur prishja nga Prokuroria e Pergjithshme dhe është regjistruar procedimi penal.

3. Mosfillim nr.487 i vitit 2014, është vendosur prishja nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe është regjistruar procedimi penal.
4. Mosfillim nr.994 i vitit 2014, është vendosur prishja nga Gjykata Shkallës e Apelit dhe është regjistruar procedimi penal.
5. Mosfillim nr.848 i vitit 2015, është vendosur prishja nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe është regjistruar procedimi penal.
6. Mosfillim nr.1897 i vitit 2014, është vendosur prishja nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe është regjistruar procedimi penal.

Në lidhje me një pjesë të madhe e kallëzimeve për të cilat është vendosur mosfillimi janë kryer verifikime faktesh rrethanash apo administrim dokumentash, duke justifikuar plotësisht shkaqet e mosfillimit, brenda një afati 30- ditor, dhe pjesa dërmuese e vendimeve janë marrë brenda këtij afati.

II. ÇËSHTJE PENALE TË REGJISTRUARA DHE HETUARA.

VITI 2016

| Çeshtje te reja | Te Mbartura | Te rifilluara te pushuara | Te rifilluara te pezulluara | Gjithsenj |
|-----------------|-------------|---------------------------|-----------------------------|-------------|
| 1008 | 342 | 5 | 15 | 1370 |

VITI 2015

| Çeshtje te reja | Te Mbartura | Te rifilluara te pushuara | Te rifilluara te pezulluara | Gjithsenj |
|-----------------|-------------|---------------------------|-----------------------------|-------------|
| 1199 | 460 | 1 | 6 | 1666 |

Nisur nga krahasimet statistikore te bera per vitet 2016-2015 rezulton nje numer ne renie i procedimeve penale te regjistruara ne vitin 2016 dhe konkretisht kemi nje renie me 296 procedimesh.

Kanë përfunduar hetimet gjithsej për **1071** procedime penale, kundrejt **1329-çështjeve penale që janë përfunduar gjatë vitit 2015.**

Pra nga numri i përgjithshëm i kallëzimeve penale dhe i çështjeve të regjistruara, rezulton se gjatë kësaj periudhe në krahasim me vitin 2015 ka patur një renie të kallëzimeve dhe çështjeve penale të regjistruara dhe hetuara, kjo nisur dhe nga ndergjegjesimi i qytetareve per te respektuar legjislacionin penal ne fuqi, konkretisht duke evituar kyesisht ndertimet e paligjshme, drejtimin e automjeteve ne menyre te parregullt si dhe vjedhjen e energjise elektrike, vepra penale keto te cilat ne vitet 2013-2014-2015 kane qene te shumta ne numer duke rritur ne menyre te konsiderueshme numrin total te procedimeve te regjistruara dhe te hetuara ne prokurori.

Gjithashtu, rezulton se në organikën e Prokurorisë Prane Gjykates se Shkalles se Pare Lezhe janë 10 prokurorë, perfshire drejtuesin dhe zevendes drejtuesin e prokurorisë kurse efektivë për gjithë vitin kanë qenë vetëm 8 prokurorë.

DREJTIMET, SHTRIRJA DHE TENDENCAT E PËRHAPJES SË VEPRAVE PENALE NË PËRGJITHËSI DHE /OSE GRUP VEPRAVE PENALE NË VEÇANTI.

Në lidhje me tendencën e kriminalitetit, të përhapjes së veprave penale në përgjithësi apo me grup veprash penale të veçanta rezultojnë se veprat penale me një shtrirje dhe përhapje më të madhe janë ato **kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike me 382 – procedime të reja e 146 të mbartura, gjithsej 528 procedime penale.**

VITI 2016

| Nenet | Çeshtje të reja të regjistruar | Çeshtje të mbartura | Gjithsej |
|---------------|--------------------------------|---------------------|------------|
| 134 -142 | 203 | 69 | 272 |
| 143- 143/b2 | 53 | 13 | 66 |
| 150 - 162 | 32 | 12 | 44 |
| 163 – 170/b | 1 | 4 | 5 |
| 170c/1-170ç/2 | 0 | 0 | 0 |
| 171 – 179/ç-2 | 3 | 0 | 3 |
| 180 – 182/a | 25 | 17 | 42 |
| 183 – 185/2 | 1 | 0 | 1 |
| 186 – 192/b | 26 | 11 | 37 |
| 193 - 196 | 0 | 0 | 0 |
| 197 - 198 | 3 | 4 | 7 |
| 199 - 200 | 35 | 16 | 51 |
| | 382 | 146 | 528 |

Në lidhje me tendencën e kriminalitetit, të përhapjes së veprave penale në përgjithësi apo me grup veprash penale të veçanta rezultojnë se veprat penale me një shtrirje dhe përhapje më të madhe janë ato **kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike me 548 – procedime të reja e 255 të mbartura, gjithsej 803 procedime penale.**

VITI 2015

| Nenet | Çeshtje të reja të regjistruar | Çeshtje të mbartura | Gjithsej |
|---------------|--------------------------------|---------------------|------------|
| 134 -142 | 343 | 115 | 460 |
| 143- 143/b2 | 29 | 11 | 40 |
| 150 - 162 | 41 | 18 | 59 |
| 163 – 170/b | 4 | 2 | 6 |
| 170c/1-170ç/2 | 0 | 0 | 0 |
| 171 – 179/ç-2 | 2 | 7 | 9 |
| 180 – 182/a | 43 | 12 | 55 |
| 183 – 185/2 | 4 | 2 | 6 |
| 186 – 192/b | 33 | 19 | 52 |
| 193 - 196 | 0 | 0 | 0 |
| 197 - 198 | 15 | 28 | 43 |
| 199 - 200 | 34 | 41 | 75 |
| | 548 | 255 | 803 |

Siç evidentohet nga të dhënat statistikore të krahasuara në tabelë rezultojnë se për vitin 2016 kemi një rënie të madhe të krimeve kundër pasurisë dhe ekonomisë e konkretisht kemi 275 procedime penale me pak, krahasuar me të dhënat e vitit 2015.

Pas këtij evidentimi duhet përmendur veprat penale që kanë të bëjnë me krime **kundër autoritetit të shtetit, respektivisht 418-procedime penale e 155- procedime të mbartura, gjithsej 573-procedime;**

VITI 2016

| Nenet | Çeshtje te reja te regjistruar | Çeshtje te mbartura | Gjithsenj |
|---------------|--------------------------------|---------------------|------------|
| 235 - 247/2 | 34 | 11 | 45 |
| 248 - 260 | 37 | 30 | 67 |
| 261/1 – 293/d | 347 | 114 | 461 |
| 294 - 299 | 0 | 0 | 0 |
| | 418 | 155 | 573 |

VITI 2015

| Nenet | Çeshtje te reja te regjistruar | Çeshtje te mbartura | Gjithsenj |
|---------------|--------------------------------|---------------------|------------|
| 235 - 247/2 | 35 | 16 | 51 |
| 248 – 260 | 54 | 38 | 92 |
| 261/1 – 293/d | 410 | 77 | 487 |
| 294 - 299 | 0 | 0 | 0 |
| | 499 | 131 | 630 |

Siç evidentohet nga te dhenat statistikore te krahasuara ne tabela rezulton se per vitin 2016 kemi nje renie te krimeve kunder autoritetit te shtetit e konkretisht kemi 57 procedime penale me pak, krahasuar me te dhenat e vitit 2015.

Veprat penale të drejtuara kundër jetës së personit rezultojnë se për vitin 2016 janë regjistruar 128 procedime e 30 procedime te mbartura, gjithsenj 158 procedime.

VITI 2016

| Nenet | Çeshtje te reja te regjistruar | Çeshtje te mbartura | Gjithsenj |
|-----------------|--------------------------------|---------------------|------------|
| 76 – 85 | 32 | 8 | 40 |
| 86 - 92 | 29 | 4 | 33 |
| 93 - 99 | 10 | 1 | 11 |
| 100/1 – 108 a-2 | 0 | 0 | 0 |
| 109 - 112 | 2 | 1 | 3 |
| 113 - 123 | 11 | 3 | 14 |
| 124 – 130/a/4 | 44 | 13 | 57 |
| | 128 | 30 | 158 |

VITI 2015

| Nenet | Çeshtje te reja te regjistruar | Çeshtje te mbartura | Gjithsenj |
|-----------------|--------------------------------|---------------------|------------|
| 76 – 85 | 23 | 19 | 42 |
| 86 - 92 | 16 | 8 | 24 |
| 93 - 99 | 6 | 0 | 6 |
| 100/1 – 108 a-2 | 4 | 3 | 7 |
| 109 - 112 | 5 | 5 | 10 |
| 113 - 123 | 14 | 6 | 20 |
| 124 – 130/a/4 | 37 | 14 | 51 |
| | 105 | 55 | 160 |

Siç evidentohet ne te dhenat statsitikore te krahasuara ne tabela, rezulton per vitin 2016 ne fushen e krimeve kunder personit kemi 2 procedime me pak krahasuar me te dhenat e vitit 2015.

Gjithashtu, në vështrim të tendencës së kriminalitetit duhet evidentuar fakti i regjistrimit dhe të **57-procedimeve penale te reja dhe 7 procedimeve te mbartura, gjithsenj 64 procedime ne fushen e krimeve kundër drejtësisë, nenet 300-326.**

VITI 2016

| Nenet | Çeshtje te reja te regjistruar | Çeshtje te mbartura | Gjithsenj |
|-----------|--------------------------------|---------------------|-----------|
| 300 - 326 | 57 | 7 | 64 |
| | 57 | 7 | 64 |

VITI 2015

| Nenet | Çeshtje te reja te regjistruar | Çeshtje te mbartura | Gjithsenj |
|-----------|--------------------------------|---------------------|-----------|
| 300 - 326 | 26 | 9 | 35 |
| | 26 | 9 | 35 |

Siç evidentohet ne te dhenat statsitkore te krahasuara ne tabela, rezulton per vitin 2016 ne fushen e krimeve kunder drejtesise kemi nje rritje te numrit te procedimeve te regjistruara krahasuar me te dhenat e vitit 2015 me 29 procedime penale me shume.

Veprave penale kundër mjedisit te regjistruara per vitin 2016, 17 procedime penale te rej e 4 procedime te mbbartura gjithsenj 21 procedime penale.

VITI 2016

| Nenet | Çeshtje te reja te regjistruar | Çeshtje te mbartura | Gjithsenj |
|-----------|--------------------------------|---------------------|-----------|
| 201 - 207 | 17 | 4 | 21 |
| | 17 | 4 | 21 |

VITI 2015

| Nenet | Çeshtje te reja te regjistruar | Çeshtje te mbartura | Gjithsenj |
|-----------|--------------------------------|---------------------|-----------|
| 201 - 207 | 19 | 10 | 29 |
| | 19 | 10 | 29 |

Siç evedentohet nga te dhenat statsitkore rezulton se per vitin 2016 ne fushen e veprave penale kunder mjedisit kemi nje renie te procedimeve te regjistruara ne krahasim me vitin 2015 me 8 procedime me pak.

III. MËNYRA E PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE.

Gjatë këtij viti kemi patur në hetim **1370** procedime penale (të regjistruara gjatë këtij viti + të mbartura nga viti i kaluar). Kanë përfunduar hetimet dhe është konkluduar në vendim përfundimtar për **1071** çështje penale për vitin 2016, duke mbartur në hetim **299** - çështje penale për vitin 2017. Gjithashtu, janë dërguar për gjykim **356** procedime penale; pushuar **316** procedime; pezulluar **354** procedime dhe transferuar **45** procedime.

Gjate vitit 2015 kemi patur ne hetim **1666** procedime penale (të regjistruara gjatë këtij viti + të mbartura nga viti i kaluar) ku eshte konkluduar me vendim perfundimtar per **1329** çeshtje

duke mbartur ne hetim **337** procedime penale. Gjithashtu gjate vitit 2015 jane derguar per gjykim **464** procedime, pushuar **401** procedime, pezulluar **399** procedime, transferuar **65** procedime.

Krahasuar me vitin e mëparshem, vitin 2015 kemi një tendencë **në renie sa i përket procedimeve penale** të regjistruara, një renie të numrit të çështjeve penale të dërguara për gjykim, renie te numrit të çështjeve të pushuara, dhe renie të numrit të çështjeve të pezulluara e te transferuara.

Duke parë numrin 45-të çështjeve te transferuara, numri më i madh i tyre rreth 90 %, i janë transferuar për kompetencë lëndore seksionit të të miturve në Shkodër (ligjit 5351 dt.11.06.2007), kryesisht me autor, shumica dhe me masa sigurimi dhe me veprime pothuajse të përfunduara.

PERSONA NËN HETIM VITI 2016, KRAHASUAR ME VITIN 2015

Në këto procedime penale per vitin 2016 rezulton se është regjistruar emri i 798-personave me cilësinë e të dyshuarit për një veprë penale në vendimin e regjistrimit, pra me cilësinë ndaj të cilëve zhvillohen hetime.

Nga këta, kanë përfunduar hetimet për 652-persona, ku 398-personave u janë njoftuar akuzat përkatësen, njoftimit të akuzës neni 34 K.Pr.P janë dërguar për gjykim; për 45-persona nën hetim është vendosur transferimi i procedimeve penale; për 209-persona të dyshuar është vendosur pushimi i çështjes në ngarkim të tyre, është vendosur pushimi i akuzës dhe hetimet janë pezulluar për zbulim autori.

Duhet patur parasysh rastet e pushimit sipas grup veprave penale, evidentohen kryesisht për veprën penale të “Shkeljes së Rregullave të Qarkullimit Rrugor”; “Plagosje të lehtë” ; “Fshehje e te ardhurave” “Ndertimet e paligjshme “ “kundërshtimi i punonjesve qe kyejne detyra shteterore“ “Mosbindja ndaj urdherit te punonjesit te policise “ si dhe “ Prodhimi dhe shitja e narkotikeve “ (ku ka rezultuar se personat nen hetim kane qene perdorues te lendes narkotike dhe e kane pasur per perdorim vetiak).

Per vitin 2015 rezulton se është regjistruar emri i 980-personave me cilësinë e të dyshuarit për një veprë penale në vendimin e regjistrimit, pra me cilësinë ndaj të cilëve zhvillohen hetime.

Nga këta, kanë përfunduar hetimet për 780-persona, ku 528-personave u janë njoftuar akuzat përkatësen, njoftimit të akuzës neni 34 K.Pr.P janë dërguar për gjykim; për 64-persona nën hetim është vendosur transferimi i procedimeve penale; për 188-persona të dyshuar është vendosur pushimi i çështjes në ngarkim të tyre, është vendosur pushimi i akuzës dhe hetimet janë pezulluar për zbulim autori.

Duhet patur parasysh rastet e pushimit sipas grup veprave penale, evidentohen kryesisht për veprën penale të “Shkeljes së Rregullave të Qarkullimit Rrugor”; “Plagosje të lehtë“ “ Shpërdorimi i detyres “ “ Organizimi i llotarive te palejuara “ e tjere.

Theksojmë se krahasuar me vitin 2015 evidentohet një numër në renie të personave nën hetim, konkretisht nga 182 persona me pak te regjistruar per vitin 2016.

• MASAT E SIGURIMIT VITI 2016 KRAHASUAR ME VITIN 2015

Per vitin **2016**, jane arrestuar ne flagrante nga policia gjyqesore **222** persona, ndaluar **12** persona, ku pas verifikimeve te kryera nga prokurori eshte vendosur per **4** persona eshte urdheruar lirimi i menjehershëm i te arrestuarit/ndaluarit. Jane perpiluar **230** kerkesa per vlefesim te arrestit ne flagrante/ndalimit nga te cilat ne **227** raste jane vleresuar te ligjshme nga

gjykata dhe ne 3 raste jane vlefesuar si te paligjshme arrestimet/ndalimet. Per 130 persona prokurori i ka kerkuar gjykates caktimin e mases se sigurimit " Arrest ne burg "; per 8 persona eshte kerkuar caktimi i mases se sigurimit " Arrest ne burg ne mungese ", per 4 persona eshte kerkuar " Arrest ne shtepi " per 2 persona eshte kerkuar caktimi i mases se sigurimit " Arrest ne burg me afat", per 96 raste eshte kerkuar caktimi i mases se sigurimit "Detyrim per tu paraqitur ne policine gjyqesore ", ndersa per 1 rast eshte kerkuar masa e sigurimit " Pezullimi i ushtrimit te nje detyre a sherbimi publik " .

Nga ana e Gjykatës është vendosur për 105-persona masa e sigurimit "Arrest në burg"; për 8 persona eshte caktuar masa e sigurimit "Arrest në burg në mungesë" për 13-persona "Arrest në shtëpi", për 1-person "garanci pasurore" për 110-persona masa e sigurimit "detyrim për tu paraqitur në Policine Gjyqësore", per 2-persona eshte caktuar masa e sigurimit " Pezullimi i ushtrimit te nje detyre a sherbimi publik " .

Per vitin 2015, jane arrestuar ne flagrante nga policia gjyqesore 366 persona, ndaluar 12 persona nga policia gjyqesore, 7 persona ndaluar me urdher ndalimi nga prokurori, ku pas verifikimeve te kryera nga prokurori eshte vendosur per 2 persona eshte urdheruar lirimi i menjehershem i te arrestuarit/ndaluarit. Jane perpiluar 375 kerkesa per vlefesim te arrestit ne flagrante/ndalimit nga te cilat ne 373 raste jane vleresuar te ligjshme nga gjykata dhe per 2 persona jane vlefesuar si te paligjshme arrestimet/ndalimet. Per 162 persona prokurori i ka kerkuar gjykates caktimin e mases se sigurimit " Arrest ne burg ", per 9 persona eshte kerkuar caktimi i mases se sigurimit " Arrest ne burg ne mungese ", per 11 persona eshte kerkuar " Arrest ne shtepi " per 7 persona eshte kerkuar caktimi i mases se sigurimit " Arrest ne burg me afat", per 1 rast eshte kerkuar masa e sigurimit " Garanci Pasurore " per 193 raste eshte kerkuar caktimi i mases se sigurimit "Detyrim per tu paraqitur ne policine gjyqesore ", ndersa per 4 raste eshte kerkuar masa e sigurimit " Pezullimi i ushtrimit te nje detyre a sherbimi publik " .

Nga ana e Gjykatës është vendosur për 138-persona masa e sigurimit "Arrest në burg"; për 9 persona eshte caktuar masa e sigurimit "Arrest në burg në mungesë" për 20-persona "Arrest në shtëpi", per 2 persona eshte vendosur " Arrest ne burg me afat " për 2-persona "garanci pasurore" për 212-persona masa e sigurimit "detyrim për tu paraqitur në Policine Gjyqësore", per 4-persona eshte caktuar masa e sigurimit " Pezullimi i ushtrimit te nje detyre a sherbimi publik " .

Siç evidentohet nga te dhenat e mesiperme rezulton se per vitin 2016 kemi nje nr. Me te vogel te personave te ndaluar/arrestuar ne flagrante.

Më poshtë po analizojmë mënyrën e përfundimit të çështjeve të regjistruara dhe hetuara, dhe konkretisht.

a) ÇËSHITJE TË DËRGUAR NË GJYKATË VITI 2016

Pas përfundimit të hetimeve janë dërguar për gjykim ne vitin 2016 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë **356 procedime penale me 398 të pandehur**, nga të cilët me masë sigurimi "Arrest në burg", "Arrest mungesë" janë dërguar për gjykim 132-të pandehur.

Duke ju referuar veprave penale për të cilën janë akuzuar e dërguar për gjykim të pandehurit, rezulton si më poshtë :

Për veprën penale **kundër autoritetit të shtetit** (nenet 235-299 te K.P) janë dërguar për gjykim **188 procedime penale me 216 të pandehur**, ku nga këto 64 të arrestuar.

Për veprat penale kundër pasurisë 134-200 të K.Penal janë dërguar për gjykim 71-procedime penale me 79-të pandehur, ku nga këto 18-të pandehur të arrestuar.

Për veprat penale kundër jetës së personit 76-133 të K.Penal janë dërguar për gjykim 66-procedime penale me 70-të pandehur, ku nga këto 29-të me masë sigurimi arrest në burg.

Për veprat penale kundër drejtësisë kemi neni 300-324 janë dërguar për gjykim 28 procedime me 28 te pandehur me 21 persona te arrestuar.

a)1 ÇËSHTJE TË DËRGUAR NË GJYKATË VITI 2015

Pas përfundimit të hetimeve janë dërguar për gjykim në vitin **2015** pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë 464 procedime penale me 528 të pandehur, nga të cilët me masë sigurimi “Arrest në burg“, “Arrest mungesë“ janë dërguar për gjykim **149** të pandehur.

Duke ju referuar veprave penale për të cilën janë akuzuar e dërguar për gjykim të pandehurit, rezultojnë si më poshtë :

Për veprën penale kundër autoritetit të shtetit (nenet 235-299 të K.P) janë dërguar për gjykim 228 procedime penale me 247 të pandehur, ku nga këto 52 të arrestuar.

Për veprat penale kundër pasurisë 134-200 të K.Penal janë dërguar për gjykim 158-procedime penale me 182-të pandehur, ku nga këto 57-të pandehur të arrestuar.

Për veprat penale kundër jetës së personit 76-133 të K.Penal janë dërguar për gjykim 62-procedime penale me 67-të pandehur, ku nga këto 38-të me masë sigurimi arrest në burg.

Për veprat penale kundër drejtësisë kemi neni 300-324 janë dërguar për gjykim 9 procedime me 9 te pandehur me 2 persona te arrestuar.

Siç evidentohet nga krahasimet e mesipërme rezultojnë se për vitin 2016 kemi një rënie të numrit dhe personave të dërguar për gjykim në krahasim me vitin 2015.

TIPOLOGJIA E VEPRAVE PENALE TË GJYKUARA NË VITIN 2016

Gjatë vitit 2016 pas dërgimit të procedimeve penale për gjykim, ka përfunduar gjykimi për 400-procedime penale me 461-të pandehur, nga të cilët 45-të pandehur me masë sigurie “arrest në burg”.

- Nga Prokuroria për 73 të pandehur është kërkuar dënimi me gjobe, për 10 të pandehur është kërkuar dënimi me burgim në minimum, për 249 të pandehur është kërkuar dënimi me burgim mesatar, për 6 të pandehur është kërkuar dënimi me burgim në maksimum, për 101 të pandehur është kërkuar dënimi alternativ (nenet 63-59), për 8 të pandehur është kërkuar tërheqja e akteve, për 5 të pandehur është kërkuar pushimi i çështjes.

- Nga ana e **Gjykatës**, në lidhje me kërkesat e bëra nga Prokuroria që parashtruan më sipër është vendosur denimi me gjobe per 67 persona, per 19 persona denimi me burgim ne minimum, per 195 persona denimi me burgim mesatar, per 3 te pandehur burgim ne maksimum, per 122 te pandehur denim alternativ (nenet 63 – 59), per 8 te pandehur terheqje aktesh, per 1 te pandehur pushim akuze, per 11 te pandehur pushim çeshtje, 25 raste eshte dhene pafajesi.

Te pandehurit e denuar per vitin 2016, jane pergjithesisht meshkuj, vetem 7 femra, dhe vetem 1 shtetas i huaj, te cilet kryesisht jane persona me aresim te mesem dhe 9 vjecar, ndersa nje numer shum me i vogel rezulton me aresim te larte. Nga te dhenat e mbledhura rezulton se kyersisht jane te papune dhe te padenuar me vendbanime te shperndare pothuajse ne menyre te barabarte si ne qytet dhe neper komuna.

Gjatë vitit 2015 pas dërgimit të procedimeve penale për gjykim, ka përfunduar gjykimi për 493-procedime penale me 524-të pandehur, nga të cilët 29-të pandehur me masë sigurie “arrest në burg”.

- Nga **Prokuroria** për 145 të pandehur është kërkuar dënimi me gjobe,per 5 te pandehur eshte kerkuar denimi me burgim ne minimum, per 191 te pandehur eshte kerkuar denimi me burgim mesatar, per 2 te pandehur eshte kerkuar denimi me burgim ne maksimum,per 1 te pandehur eshte kerkuar denimi me burgim te perjetshem, per 168 te pandehur eshte kerkuar denimi alternativ (nenet 63-59), per 10 te pandehur eshte kerkuar terheqja e akteve, per 7 te pandehur eshte kerkuar pushimi i çeshtjes.

- Nga ana e **Gjykatës**, në lidhje me kërkesat e bëra nga Prokuroria që parashtruan më sipër është vendosur denimi me gjobe per 139 persona, per 6 persona denimi me burgim ne minimum, per 179 persona denimi me burgim mesatar, per 2 te pandehur burgim ne maksimum,per 1 te pandehur burgim te perjetshem, per 173 te pandehur denim alternativ (nenet 63 – 59), per 10 te pandehur terheqje aktesh, per 10 te pandehur pushim çeshtje, 12 raste eshte dhene pafajesi.

Te pandehurit e denuar per vitin 2015, jane pergjithesisht meshkuj, vetem 16 femra, , te cilet pjesa dermuese jane persona me aresim te mesem,me aresim 9 vjecar gjithashtu kemi nje numer te konsiderueshem te denuarish, ndersa nje numer shum me i vogel rezulton me aresim te larte. Nga te dhenat e mbledhura rezulton se kyersisht jane te papune dhe te padenuar me vendbanime te shperndare ne pjesen me te madhe te tyre neper komuna.

Ng ate dhenat e krahasuar me lart rezulton se ne vitin 2016 kemi nje renje te numrit te çeshtjeve dhe te pandehurve te gjykuar, krahasuar me vitin 2015.

TIPOLOGJIA E LLOJEVE TË GJYKIMEVE VITI 2016 KRAHASUAR ME VITIN 2015.

Gjatë vitit 2016, jane aplikuar 6 gjykime te drejtperdrejta me 6 te pandehur, 4 gjykime te zakonshme me 7 te pandehur, 387 gjykime te shkurtuara me 443 te pandehur, 3 gjykime ne mungese me 5 te pandehur,jane dhene gjithsenj 25 pafajesi nga gjykata.

Gjatë vitit 2015, janë aplikuar 13 gjykime të drejtperdrejta me 13 të pandehur, 24 gjykime të zakonshme me 24 të pandehur, 454 gjykime të shkurtuara me 483 të pandehur, 2 gjykime në mungesë me 4 të pandehur, janë dhënë gjithashtu 12 pafajësi nga gjykata.

Këto pafajësi po i evidentojmë si më poshtë :

1. Vendimi nr. 29 dt. 26.01.2016, (A.Ndreca) për nënin 301 K.P. ku është dhënë pafajësi (e pjesshme) për 1 të pandehur, (është ushtruar apel, dhe akoma nuk ka përfunduar gjykimi). *Prokuror E.Koloshi.*
2. Vendimi nr. 69 dt.18.02.2016 (K.Kaceli), nëni 289 i K.P me 1-të pandehur apeluar nuk ka përfunduar gjykimi. *Prokuror A.Agovi.*
3. Vendimi nr.151 dt.06.05.2016, (Gj.Sinani - Z.Jaku) nëni 326 ku është dhënë pafajësi për 2 të pandehur (pafajësi e pjesshme), apeluar nuk ka përfunduar gjykimi. *Prokuror E.Shehaj.*
4. Vendimi nr.165 dt.24.05.2016 (A.Prendi) ku është dhënë pafajësi nëni 305 (te pjesshme) për 1 të pandehur. Është ushtruar apel, dhe nuk ka përfunduar gjykimi. *Prokuror A.Agovi.*
5. Vendimi nr. 168 dt. 28.05.2016 nëni 204 me 2 të pandehur ku është dhënë pafajësi për dy të pandehur. (është ushtruar apel, dhe akoma nuk ka përfunduar gjykimi). *Prokuror E.Koloshi.*
6. Vendimi nr.220 dt.12.07.2016 (M.Palaj) për nënin 134 të K.P me 1-të pandehur, është ushtruar apel, dhe nuk ka përfunduar. *Prokuror E.Shehaj.*
7. Vendimi nr. 224 dt. 14.07.2016 (H.Abedini) për nënin 130/a me 1-të pandehur, ku pafajësi është dhënë vetëm për 1 të pandehur. (Është ushtruar apel dhe akoma nuk ka përfunduar gjykimi). *Prokurori B.Lleshi .*
8. Vendimi nr. 233 dt. 21.07.2016 (L.Pali) për nënin 127 me 1 të pandehur, (Është ushtruar apel dhe akoma nuk ka përfunduar gjykimi). *Prokurori .Gj.Rudi .*
9. Vendimi nr.239 dt. 28.07.2016 (R.Smaçi) për nënet 135-186 me 1-të pandehur, ku është dhënë pafajësi për 1 të pandehur (Është ushtruar apel dhe akoma nuk ka përfunduar gjykimi). *Prokurori .R.Fishta.*
10. Vendimi nr.241 dt. 28.07.2016 nëni 248 (B.Dani, D.Malçi,Gj.Pali) me 3 të pandehur, ku është dhënë pafajësi për te 3 të pandehurit. (Eshtë ankimuar dhe çeshtja është në apel dhe akoma nuk ka përfunduar gjykimi) *Prokurori S.Kastrati.*
11. Vendimi nr.244 dt. 02.09.2016 nëni 139 (M.Tirtja – F.Tirtja) me 3 të pandehur ku është dhënë pafajësi për te dy të pandehurit. (Eshtë ankimuar dhe çeshtja është në apel por akoma nuk është gjykuar) *Prokurori E.Shehaj.*
12. Vendimi nr. 254 dt. 08.09.2016 nënet 89 e 302 të K.P. (E.Lesaj-A.Deda) ku është dhënë pafajësi për 2 të pandehurit. (është ankimuar dhe çeshtja është në apel ku akoma nuk është gjykuar) *prokurori B.Lleshi.*
13. Vendimi nr. 347 dt. 23.11.2016 për nënin 272 K.P (A.Qose) ku është dhënë pafajësi për 1 të pandehur. (është ankimuar dhe çeshtja është në apel ku akoma nuk është gjykuar) *prokurori R.Fishta.*
14. Vendimi nr. 366 dt. 05.12.2016 nëni 199/a/2 K.P (B.Lleshi) ku është dhënë pafajësi për 1 të pandehur. . (është ankimuar dhe çeshtja është në apel ku akoma nuk është gjykuar) *prokurori B.Lleshi.*

15. Vendimi nr. 369 dt. 06.12.2016 neni 242 K.P (P.Pjetri) ku eshte dhene pafajesi per 1 te pandehur. (eshte ankimuar dhe ceshtja eshte ne apel ku akoma nuk eshte gjykuar) *prokurori B.Lleshi.*
16. Vendimi nr. 382 dt. 14.12.2016 neni 283/2 K.P (A.Deda-P.Deda) me 3 te pandehur ku eshte dhene pafajesi (e pjesshme) per 2 te pandehur. (eshte ankimuar dhe ceshtja eshte ne apel ku akoma nuk eshte gjykuar) *prokurori B.Lleshi.*
17. Vendimi nr. 262 dt. 09.09.2016 nenet 76-300-278 K.P (M.Pergjini) me 4 te pandehur ku eshte dhene pafajesi (e pjesshme) per 1 te pandehur per nenet 76-278. (eshte ankimuar dhe ceshtja eshte ne apel ku akoma nuk eshte gjykuar) *prokurori E.Shehaj.*
18. Vendimi nr. 329 dt. 14.11.2016 neni 78-278 K.P (P.Maroci) me 2 te pandehur ku eshte dhene pafajesi (e pjesshme) per 1 te pandehur. (eshte ankimuar dhe ceshtja eshte ne apel ku akoma nuk eshte gjykuar) *prokurori M.Bleta.*

Për të gjitha rastet, është apeluar vendimi i pafajësisë në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Apelimet në Gjykatën e Apelit

Nga çështjet e gjykuara dhe të përfunduara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë në 61-raste është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Konkretisht, janë ankimuar në Gjykatën e Apelit Shkodër vendimet, në lidhje me gjykimin të pandehurve, ku rezultojnë në 25-raste pafajësie. Akoma nuk janë shqyrtuar ankimimet.

Është ushtruar ankim për disa vendime për masa sigurimi ne Gjykatën e Apelit Shkodër,si dhe per disa ceshtje vendime themeli të cilat janë në shqyrtim.

Është ushtruar ankim për 17-raste te vendimit të Gjykatës për lirim para kohe me kusht sipas nenit 64 të K.Penal.

GJYKIME ME OBJEKT LIRIM PARA KOHE ME KUSHT

Nga Prokurorët është perballuar një ngarkesë e konsiderueshme e gjykimeve penale me objekt kërkesat për lirim para kohe me kusht sipas nenit 64 dhe qëndrimi në shtëpi sipas nenit 59/a të K.Penal, në total prej **199** çështjesh, kjo për shkak të përfshirjes së I.E.V.P Shënkoll në juridiksionin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. (*Shih tabelën f.19*)

Konkretisht, është marrë pjesë nga Prokurorët në **199**-çështje administrative me objekt “lirim para kohe me kusht” , dënim alternativ dhe kërkesa te tjera te veçaanta ,ndryshim vendit vuajtjes denimin,shuarje mase sigurimi,etj, pra gjithsej 199 kërkesa.

Nga **199**- gjykime me objekt te sipercituar rezulton se per vitin 2016 ka perfunduar gjykimi per **187** kerkesa, ku ne **137** raste eshte vendosur pushimi i gjykimit, ne **28** raste eshte vednusur rrezimi i kerkeses se te denuarit, ne **5** raste eshte vendosur shpallja e moskopesences si he ne **17** raste eshte vendosur pranimi i kerkeses se te denuarit.

Në Gjykimet me objekt lirim para kohe me kusht duhen evidentuar disa mangësi e konkretisht. Megjithëse janë gjykime administrative, Prokurorëve u është krijuar një ngarkesë relativisht e madhe, seancat shtyhen disa herë, përgjithësisht për mungesë dokumentacioni të paraqitur bashkangjitur kërkesës nga të dënuarit që vuajnë dënimin.

b) PROCEDIME PENALE TË PUSHUARA VITI 2016 KRAHASUAR ME VITIN 2015

Gjatë vitit 2016, nga Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Lezhë është vendosur pushimi për 316-procedime penale me 209-autorë të dyshuar (regjistruar emri) nga keto 4-persona te arrestuar. Në të gjitha këto procedime penale përgjithësisht janë kryer veprime hetimore të plota dhe në çdo rast është bërë njoftimi i vendimit të pushimit si kallëzimeve, institucioneve apo individëve, dhe palëve të interesuara.

Duke ju referuar statistikës rezulton se :

Për nenet (76 – 133) jane pushuar 48 -procedime penale me 37 – persona nen hetim.

Per nenet (134 – 200) jane pushuar 108-procedime me 66-persona nen hetim.

Per nenet (201 – 207) jane pushuar 4-rocedime me 3-persona nen hetim.

Per nenet (235 – 299) jane pushuar 148-procedime me 96-persona nen hetim nga keto 4-persona me mase sigurimi “ Arrest ne Burg “.

Per nenet (300 – 324) jane pushuar 8-procedime me 7-persona nen hetim.

Gjatë vitit 2015, nga Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Lezhë është vendosur pushimi për 401-procedime penale me 188-autorë të dyshuar (regjistruar emri) nga keto 4-persona te arrestuar. Në të gjitha këto procedime penale përgjithësisht janë kryer veprime hetimore të plota dhe në çdo rast është bërë njoftimi i vendimit të pushimit si kallëzimeve, institucioneve apo individëve, dhe palëve të interesuara.

Duke ju referuar statistikës rezulton se :

Krime kunder personit dhe jetes, nenet (76 – 133) jane pushuar 48 -procedime penale me 28- persona nen hetim.

Krime kunder pasurise dhe ekonomise, nenet (134 – 200) jane pushuar 158-procedime me 74-persona nen hetim, nga keto 2-persona me mase sigurimi “Arrest ne Burg “.

Krime kunder mjedisit, nenet (201 – 207) jane pushuar 18-rocedime me 10-persona nen hetim.

Krime kunder autoritetit te shtetit, nenet (235 – 299) jane pushuar 167-procedime me 68-persona nen hetim nga keto 2-persona me mase sigurimi “ Arrest ne Burg “.

Krime kunder drejtesise, nenet (300 – 324) jane pushuar 10-procedime me 8-persona nen hetim.

Nisur nga krahasimet e mesiperme rezulton se ne vitin 2016 kemi nje ulje te numrit te pergjithshem te procedimeve penale te pushuar (85) me pak, por kemi nje rritje te numrit te personave nen hetim (regjistruar emri) me (21) persona me shume se ne vitin 2015.

c) PROCEDIME PENALE TË PEZULLUARA VITI 2016 KRAHASUAR ME VITIN 2015

Per vitin 2016 është vendosur pezullimi i hetimeve në bazë të nenit 326 të K.Pr.Penale për 316 procedime penale të cilat janë të ndara me grup veprash si më poshtë:

Këto procedime penale kryesisht janë me vend-ngjarje të referuara nga seksionet e policisë Gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë Qarkut Lezhë. Në të gjitha rastet është urdhëruar kryerja e veprimeve hetimore, si dhe deleguar veprime të posaçme në veprime të veçanta dhe në përfundim bazuar dhe në relacionin e oficerëve të policisë gjyqësore është vendosur pezullimi i hetimeve.

- Vepra penale kundër pasurisë, nenet (134- 200) rezultojnë 214-procedime penale te pezulluara.
- Vepra penale kundër personit , nenet (76 – 133) rezultojnë 12 procedime penale, te pezulluara.
- Vepra penale kundër autoritetit të shtetit, nenet (235 – 299) rezultojnë 102 procedime penale te pezulluara.
- Vepra penale kundër mjedisit nenet (201 – 207) rezultojnë 9 procedime penale te pezulluara.
- Vepra penale kunder drejtesise nenet (300 – 324) rezultojnë 17 procedime penale te pezulluara.

Per vitin 2015 është vendosur pezullimi i hetimeve në bazë të nenit 326 të K.Pr.Penale për 399 procedime penale të cilat janë të ndara me grup veprash si më poshtë:

- Vepra penale kundër pasurisë, nenet (134- 200) rezultojnë 314-procedime penale te pezulluara.
- Vepra penale kundër personit , nenet (76 – 133) rezultojnë 14 procedime penale, te pezulluara.
- Vepra penale kundër autoritetit të shtetit, nenet (235 – 299) rezultojnë 66 procedime penale te pezulluara.
- Vepra penale kundër mjedisit nenet (201 – 207) rezultojnë 1 procedime penale te pezulluara.
- Vepra penale kunder drejtesise nenet (300 – 324) rezultojnë 4 procedime penale te pezulluara.

Nga krahasimet e te dhenave te mesiperme rezulton se per vitin 2016 kemi nje ulje te procedimeve penale te pezulluara se ne vitin 2015 me (83) procedime penale me pak te pezulluara.

d) PROCEDIME PENALE TË TRANSFERUARA VITI 2016 KRAHASUAR ME VITIN 2016

Per vitin 2016 është vendosur trasferimi për kompetencë për 45-procedime penale me 45-të dyshuar,(regjistruar emri) me 14-persona me mase sigurimi « arrest ne burg » ndër të cilat pjesa dërmuese i janë transferuar për kompetencë lëndore Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Seksionit të të Miturve, ndërsa të tjerat rast pas rasti për kompetencë tokësore Prokurorive përkatëse.

- Vepra penale kundër pasurisë, nenet (134- 200) rezultojnë 23-procedime penale me 21 persona nen hetim me 10 persona me mase sigurimi “Arrest ne burg”.

- Vepra penale kundër personit , nenet (76 – 133) rezultojnë 5 procedime penale, me 6 persona nen hetim.
- Vepra penale kundër autoritetit të shtetit, nenet (235 – 299) rezultojnë 16 procedime penale me 17 persona nen hetim, me 4 persona me mase sigurimi “Arrest ne burg”.
- Vepra penale kunder drejtesise nenet (300 – 324) rezultojnë 1 procedim penale me 1 person nen hetim.

Per vitin 2015 është vendosur trasferimi për kompetencë për 65-procedime penale me 64-të dyshuar,(regjistruar emri) me 16-persona me mase sigurimi « arrest ne burg » ndër të cilat pjesa dërmuese i janë transferuar për kompetencë lëndore Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Seksionit të të Miturve, ndërsa të tjerat rast pas rasti për kompetencë tokësore Prokurorive përkatëse.

- Vepra penale kundër pasurisë, nenet (134- 200) rezultojnë 36-procedime penale me 34 persona nen hetim me 11 persona me mase sigurimi “Arrest ne burg”.
- Vepra penale kundër personit , nenet (76 – 133) rezultojnë 5 procedime penale, me 6 persona nen hetim me 3 persona me mase sigurimi “Arrest ne Burg”.
- Vepra penale kundër autoritetit të shtetit, nenet (235 – 299) rezultojnë 19 procedime penale me 18 persona nen hetim, me 2 persona me mase sigurimi “Arrest ne burg”.
- Vepra penale kunder drejtesise nenet (300 – 324) rezultojnë 5 procedim penale me 6 person nen hetim.

Nga krahasimet e te dhenave te mesiperme rezulton se per vitin 2016 kemi nje renie te numrit te procedimeve te transferuara me 20 procedime penale me pak se ne vitin 2015.

III. SHPEJTËSIA ME HETIMET PARAPRAKE DHE AFATET E PARABURGIMIT VITI 2016 KRAHASUAR ME VITIN 2015

Nga treguesit kryesorë të veprimtarisë së punës së prokurorëve dhe trupës së oficerëve të policisë Gjyqësore të Prokurorisë dhe shërbimeve pranë D.P.Q Lezhë, është shpejtësia e veprimeve hetimore në hetimet paraprake e cila ka të bëjë në respektimin e dispozitave proceduriale penale për afatet e hetimit dhe në veçanti ato të paraburgimit me të pandehur të arrestuar.

Rezulton se përgjithësisht janë respektuar kriteret e afateve të hetimit.

Gjatë hetimeve paraprake është kërkuar zgjatja afati hetimor vetëm për **70-procedime me 88 persona nen hetim me 23 persona me mase sigurimi « Arrest ne burg « nga 1370-çështje të hetura gjithsej, krahasuar me 87-procedime me 89-persona nen hetim me 17-persona me msae sigurimi « Arrest ne burg », nga 1666 çështje te hetuara gjithsenj ne vitin 2015.**

Në lidhje me afatet e paraburgimit ne vitin 2016 kemi pasur vetem 2 raste te kalimit te afateve te paraburgimit, për rrjedhojë kemi drejtuar kërkesë drejtuar gjykatës për zgjatjen e afatit të paraburgimit, kerkesa te cilat jane miratuar nga ana e gjykates.

Duke ju referuar sa thamë më sipër rezulton se shpejtësia në hetim ka qenë në tregues pozitiv. Duhet evidentuar fakti se jo rrallë zgjatjet janë vendosur për shkak të zvarritjes së veprimeve nga shërbimet e Pol.Gjyqësore të cilat kanë relatuar me vonesë për dinamikën dhe gjendjen e hetimeve.

EKZEKUTIMI I VENDIME PENALE VITI 2016 KRAHASUAR ME VITIN 2015.

Në vitin 2016, janë nxjerrë nga Prokurori i ekzekutimeve, i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve penale **414 urdhëra ekzekutimi vendimesh penale**, të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Nga këto **329-urdhëra ekzekutimi të dënimit me burgim**, janë nxjerre **77 urdhëra për dënimet me gjobë** ;janë nxjerrë **8 urdhëra për dënimet plotësuese** .

Janë nxjerrë **91 urdhëra për dënimet alternative (neni 59 K.Penal)** ;Janë nxjerrë **2 urdhëra (neni 59/a)**, jane nxjerre **55 urdhëra për nenin 63 K.Penal**;Janë nxjerrë **21 urdhëra për nenin 64 K.Penal**.

Në çdo rast është kërkuar ekzekutimi i shpenzimeve proceduriale dhe gjyqësore.

Ka përfunduar ekzekutimi për këtë periudhë për **337 urdhëra** si më poshtë; janë ekzekutuar **306 urdhëra për dënimet me burgim**,janë ekzekutuar **23 urdhëra për dënimet me gjobë** ;janë ekzekutuar **8 urdhëra për dënimet plotësuese**, jane ekzekutuar **90 urdhëra per denime alternative (neni 59)** , jane ekzekutuar **2 urdhëra per nenin (59/a)**, jane ekzekutuar **55 urdhëra per (nenin 63)**, jane ekzekutuar **21 urdhëra per (nenin 64)**.

Ngelen te paekzekutuar **77 urdhëra gjithsej**, nga te cilet **23 me burgim**, **54 me gjobe**, e **1 urdher per denim alternativ**.

Jane ekzekutuar gjithsej per vitin 2016, 38 leterporosi, 3 raste te transferimit te te denuarve nga jashte shtetit dhe per jashte shtetit, 5 njohje te vendimeve penale te hauja.

Gjithashtu jane nxjerre **7 urdhëra kerkimi nderkombetar**, si dhe jane nxjerre **5 urdhëra per heqje nga kerkimi nderkombetar**.

Në vitin 2015, janë nxjerrë nga Prokurori i ekzekutimeve, i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve penale **487 urdhëra ekzekutimi vendimesh penale**, të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Nga këto, **1-urdher ekzekutimi me burgim te perjetshem**, **384-urdhëra ekzekutimi të dënimit me burgim**, janë nxjerre **91 urdhëra për dënimet me gjobë** ;janë nxjerrë **11 urdhëra për dënimet plotësuese** .

Janë nxjerrë **119 urdhëra për dënimet alternative (neni 59 K.Penal)** ;Janë nxjerrë **4 urdhëra (neni 59/a)**, jane nxjerre **52 urdhëra për nenin 63 K.Penal**;Janë nxjerrë **29 urdhëra për nenin 64 K.Penal**.

Në çdo rast është kërkuar ekzekutimi i shpenzimeve proceduriale dhe gjyqësore.

Ka përfunduar ekzekutimi për këtë periudhë për **392 urdhëra** si më poshtë; janë ekzekutuar **371 urdhëra për dënimet me burgim**,janë ekzekutuar **26 urdhëra për dënimet me gjobë** ;janë ekzekutuar **7 urdhëra për dënimet plotësuese**, jane ekzekutuar **118 urdhëra per denime alternative (neni 59)** , jane ekzekutuar **4 urdhëra per nenin (59/a)**, jane ekzekutuar **52 urdhëra per (nenin 63)**, jane ekzekutuar **28 urdhëra per (nenin 64)**.

Ngelen te paekzekutuar **83 urdhëra gjithsej**, nga te cilet, **1 me burgim te perjetshem**, **13 me burgim**, **65 me gjobe**, e **4 urdhëra per denime plotësuese**,**1 per nenin 59**, **1 per nenin 64..**

Jane ekzekutuar gjithsej per vitin 2015, 12 leterporosi, 2 ekstradime nga jashte shtetit te te denuarve, 1 njohje te vendimeve penale te hauj.

Gjithashtu jane nxjerre **19 urdhëra kerkimi nderkombetar**, si dhe jane nxjerre **8 urdhëra per heqje nga kerkimi nderkombetar**.

Nisur nga krahasimet e te dhenave te mesiperme rezulton se per vitin 2016 kemi nje renie te numrit total te urdherave te ekzekutimit ne krahasim me vitin 2015, me 73 urdhera me pak.

Urdhëra ekzekutimi të vendimit penal për shpenzime procedurale.

*Në vitin 2016 Zyrës Përbarimit Lezhë, i janë dërguar **77** urdhëra për pagesën e shpenzimeve procedurale. Ndërsa në vitin 2015 janë regjistruar **91** urdhëra ekzekutimi për shpenzime procedurale.

*Janë likujduar plotësisht në vlerë, **3.050.465** leke, duke kaluar në favor të shtetit te cilat jane depozuar per llogari te Zyres Perbarimore, te ndara ne, **1.982.334** leke gjoba, dhe ne **1.068.131** leke shpenzime procedurale, ndersa ngelen te pa likujduara nje numer i vogel urdherash ekzekutimi, kryesisht per mungese pronesie.

Mos ekzekutimi i urdherave për masa sigurimi dhe dënime në mungesë, ka ardhur për shkak të mosgjatjes nga kërkimet e policisë të autorëve të dyshuar apo dënuar. Ndërsa në lidhje me ekzekutimin e vendimeve me gjobë në çdo rast janë evidentuar praktikat nga Zyra e Përbarimit ku është drejtuar urdhëri i ekzekutimit, dhe rast pas rasti është bërë dhe konvertimi i dënimit, siç u përmend më sipër.

TREGUESIT E VOLUMIT TË PUNËS SË PROKURORËVE

Por për të qartësuar veprimtarinë, punën individuale për çdo prokuror po paraqesim dhe treguesit për seicilin në veçanti

TË DHËNAT PËR NUMRIN E PROCEDIMEVE SIPAS PROKURORËVË

| Nr. | Prokurori | Procedime në hetim 2016 | | | | | | N.59/a N.64 | Mosfill. | Përf.gjyq |
|-----|--------------|-------------------------|------------|------------|------------|-----------|------------|----------------|------------------------|------------|
| | | Hetuar | D.gjyq | Push. | Pez. | Moskomp. | Mbart. | | | |
| 1 | A.Agovi | 181 | 44 | 49 | 41 | 14 | 32 | 0 | 62 | 53 |
| 2 | B.LLeshi | 221 | 63 | 54 | 62 | 2 | 40 | 8 | 89 | 74 |
| 3 | S.Kastrati | 220 | 77 | 43 | 62 | 7 | 31 | 3 | 73 | 84 |
| 4 | Gj.Rudi | 25 | 9 | 3 | 1 | 3 | 9 | 110 | 5 | 14 |
| 5 | M.Bleta | 167 | 24 | 44 | 46 | 0 | 53 | 7 | 146 | 21 |
| 6 | P.Vukaj | 52 | 5 | 9 | 19 | 1 | 18 | 64 | 48 | 6 |
| 7 | E.Shehaj | 212 | 57 | 47 | 49 | 6 | 53 | 7 | 76 | 57 |
| 8 | R.Fishta | 217 | 51 | 42 | 55 | 6 | 63 | 0 | 44 | 59 |
| 9 | E.Koloshi | 75 | 26 | 25 | 19 | 5 | 0 | 0 | 32 | 32 |
| | Shuma | 1370 | 356 | 316 | 354 | 45 | 299 | 199 | 530+45= 575 | 400 |

Ngarkesa e hetimit gjatë 2016-ës, ka pesuar nje renie në raport me një vit më parë. Gjykojmë se numri prej **1370** procedimesh penale të hetuara, numri prej **199** përfaqësimesh në gjyq për nenet 59; 59/a dhe 64 të K.Penal; numri prej **575** mosfillimesh si dhe **400** përfaqësime në gjyq (në total një shumë prej **2544** materiale), është një ngarkesë e madhe krahasuar me numrin e prokurorëve dhe kapacitetet njezore e finaciare që ka Prokuroria Prane Gjykes se Shkalles se Pare Lezhe.

Në kuadër të hetimeve të zhvilluara, është rritur numri i procedimeve penale ku janë aplikuar **përgjimet telefonike, ambientale, dhe vezhgitet, fotografimet, si dhe kontrollet** gjatë 2016-ës. Ne 76 raste i është kërkuar gjykes dhenia e autorizimit per pergjim, telefonik, ambiental, fotografim e vezhgit, e cila ne 73 raste ka dhene autorizim ose ka vleresuar te ligjshem lejimin e pergjimit me perjashtim te 3 rasteve kur gjykata e ka rrezuar kerkesen e prokurorit per vleftesimin e ligjshem te autorizimit te pergjimit. Gjithashtu ne 6 raste gjykata ka pranuar kerkesen e prokurorit per shtyerjen e afatit te pergjimit, si dhe ne 3 raste ka dhene autorizimim per kontrollin e vendeve (banesave e tj).

Ngarkesa e hetimit gjatë 2016-ës, gjykojmë se është një ngarkesë normale për natyrën e çështjeve, ndërkohë që duhet, evidentuar dhe shpërndarja e ngarkesës së **Oficereve te Policise Gjqësore të seksionit të Prokurorisë**, kanë përballuar një ngarkesë prej **451 -çështjes penale** (organika ka 5 oficerë të seksionit të Prokurorisë), dhe konkretisht:

Alfred Gjoka 102-procedime te hetuara, Artan Uka 102-procedime te hetuara, Mimoza Dushkaj 96-procedime te hetuara, Edison Dullaj 79-procedime te hetuara, Pashke Jaku 72-procedime te hetuara.

Gjithashtu dhe seksionet dhe shërbimet e Policisë së Shtetit, te Hetimit Tatimor, te Sherbimit te Kontrollit te Brendshem ne Sistemin e Burgjeve, ku u janë kaluar me udhër për kryerje veprimesh hetimore **919** çështje penale.

Pas urdhërit të përbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm, përgjithësisht janë respektuar procedurat e paraqitjes së akteve me referimet përkatëse, brenda afateve, sipas rastit në origjinal kur ka patur masa shtrënguese dhe fotokopje të akteve për ngjarje pa autor, ku më pas është urdhëruar kryerja e veprimeve hetimore.

MASAT DISIPLINORE NDAJ OFICERËVE TË POLICISË GJYQËSORE

Në Prokurorinë Prane Gjykes se Shkalles se Pare Lezhë, eshte ngritur Komisioni Disiplinor per vitin 2016, i perbere nga 1 Prokuror, 1 oficer i policise gjyqesore i seksionit te prokurorise si dhe nje oficer i policise gjyqesore nga struktura e oficereve te Drejtorise Vendore te Policise Lezhe. Gjate ketij viti nuk kemi pasur raste te procedimit disiplinor per oficer te policise gjyqesore.

IV. USHTRIMI I ROLIT DHE KOMPETENCAVE TË DREJTUESIT TË PROKURORISË

Në veprimtarinë e ndjekjes penale për çështjet e hetuara dhe të përfaqësuara në gjykim, një rol luan dhe ushtrimi i kontrollit nga Drejtuesi dhe Zv/Drejtuesi, në lidhje me studimin dhe vendimarrjen për regjistrimin e çështjeve penale, kontrollin në dinamikë, mënyrës së përfundimit të çështjeve, si dhe krijimit të marrëdhënieve me Prokurorët dhe Oficerët e Policisë Gjqësore, të seksionit të Prokurorisë, seksioneve dhe shërbimeve të Policisë, si dhe me Institucionet e tjera.

Gjatë periudhës që analizojmë nga Drejtuesit e Prokurorisë është ushtruar studimi i të gjitha materialeve kallëzuese dhe të referuara nga Policia Gjyqësore e ato me vendngjarje, duke marrë vendimet përkatëse për regjistrimin e çështjeve.

Evidentojmë faktin se gjatë periudhës deri më datë 01.01.2016 deri me date 14.03.2016 ka ushtruar detyrën e Drejtuesit Z.Perparim Vukaj, nga data 14.03.2016 deri me date 15.07.2016 ka ushtruar detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë Z. Zeqir Hoda, nga data 15.07.2016 e ne vijim ka ushtruar detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë Z Simon Pashuku

Në të gjitha rastet është bërë përpjekje për një respektim të një proporcionaliteti në shpërndarjen e ngarkesës për prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore, kjo e evidentuar dhe në statistikën e lartpërmendur.

Urdhërat dhe udhëzimet e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, rekomandimet e Keshillit të Ministrave, janë punuar dhe diskutuar për implementimin e tyre. Një kujdes është bërë për respektimin dhe zbatimin e urdhërit të perbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrisë të Brendshme, për funksionimin e Shërbimeve të Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit datë 15.04.2008. Në lidhje me këtë urdhër disa herë janë kryer takime dhe në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Lezhë, si dhe për çdo rast të evidentimit të shkeljeve u është dërguar shkresë përkatëse. Është ushtruar kontroll në dinamikë të çështjeve penale gjatë hetimeve paraprake, janë evidentuar dhe kërkuar verbalisht veprime konkrete që duhet të kryhen, dhe nga ana drejtuesit të Prokurorisë është vendosur dhe shfuqizimi për 11-vendime përfundimtare të prokurorëve nga drejtuesit e prokurorisë si dhe një rast është vendosur shfuqizimi i vendimit të mosfillimit nga Prokuroria e Përgjithshme.

Në rastet e zgjatjeve të afatit të hetimeve kërkesave për vleftësim dhe caktim mase sigurimi, si dhe konkluzioneve përfundimtare është zbatuar me korrektesi Urdhëri i Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me kontrollin dhe ciklin e tyre akteve dhe administrimin të një kopje në fashikullin përkatës. Janë organizuar dhe kryer analiza për çështje të veçanta të herë pas-herëshme, të protokolluara, ku është urdhëruar me shkrim kryerja e veprimeve hetimore plotësuese, si dhe në shumë raste urdhëra për riformulimin e akteve apo vendimeve përfundimtare.

V. TREGUESIT E ÇESHTJEVE PENALE TE INTEGRITETIT TE PERSONAVE QE ZGJIDHEN EMEROHEN OSE USHTROJNE FUNKSIONE PUBLIKE.

Ne zbatim të ligjit nr. 138 të vitit 2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emerohen ose ushtrojnë funksione publike “Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Lezhe, me kërkesën e Prokurorisë së Përgjithshme, Sektorit për verifikimin e Integritetit, ka kryer një sërë verifikimesh për disa persona që janë subjekt i ligjit të sipërcituar.

Gjithashtu në zbatim të këtij ligji Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Lezhe, ka regjistruar procedimin penal nr. 896 datë 17.11.2016 për veprën penale të parashikuar nga neni 190 i K.Penal në ngarkim të shtetasit A.N. administrator i Njesisë Administrative Kolsh, Bashkia Lezhe i cili kishte deklaruar të dhëna të rreme në formularin e vetedeklarit.

Pas regjistrimit të procedimit ndaj shtetasit A.N është vendosur masa e sigurimit “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a funksioni publik “ të parashikuar nga neni 242 i K.Pr.Penale.

Çështja penale e lartpërmendur është në hetim e sipër.

VI. MARRËDHENIET ME INSTITUCIONET

Marrëdhëniet institucionale me Institucionet e tjera kanë qenë ligjore dhe korrekte, dhe në veçanti me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Lezhë, Komisaritet përkatëse Lezhë dhe Mirdite, Hetimin Tatimor Rajoni Verior, Sherbimin e Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Prokurorinë e Apelit Shkodër.

Marrëdhëniet që burojnë për shkak të veprimtarisë dhe procedurave ligjore, të hetimit dhe Përfaqësimit në gjyq, pra me Policinë dhe Gjykatën, janë krijuar marrëdhënie bashkëpunimi si në aspektin organizativ ashtu dhe atë ligjor në respektim të kryerjes së detyrave në afate nga seksionet e Policisë Gjyqësore dhe shërbimet, ashtu dhe respektimin dhe korrektësinë në zhvillimin e seancave Gjyqësore me Gjykatën. Nuk janë evidentuar raste të shtyrjes së seancave gjyqësore për mosparaqitjen e prokurorëve, dhe nga ana e Gjykatës duhet vlerësuar fakti i përballimit të një ngarkese të madhe.

Por duhen evidentuar disa praktika të gabuara të Gjykatës, ku në disa raste është shtyrë seanca gjyqësore vetëm për shpallje vendimi, dhe pas shpalljes së vendimit pas disa ditësh në prokurori dërgohet vetëm një shkurtrim vendimi. Ajo që rëndon këtë fenomen janë shpalljet e vendimeve me objekt nenet 64 dhe 59/a të K.Penal.

Në lidhje me materialet kallëzuese jo të plota, kur janë evidentuar mangësi etj, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë dërguar me shkrim vërejtjet për problematiken e konstatuar në materiale kallëzuese dhe çështje penale të veçanta, ku është konfirmuar nga ana e Policisë trajtimi i problematikave të ngritura në funksion të përmirësimit të punës.

Një problematikë e evidentuar në raport me Policinë, pra shërbimet e Policisë Gjyqësore, janë lëvizjet e shpeshta të oficerëve. Duke qenë më se dakort që lëvizjet e tyre të bëhen në rastet e ngritjes në karrierë/gradë, apo afrimin e tyre pranë vendbanimeve. Ka shumë raste të zëvendësimit në një procedim penal të Of/Pol/Gjyqësore. Kjo për shkak të lëvizjeve të shpeshta nga një sektor në tjetrin, ka raste që dosjet janë sjellë në prokurori pas 1-muaji nga lëvizjet, pa relacion etj. Ajo që duhet evidentuar si mangësi është mos trajtimi i rasteve të shkeljeve duke kaluar në procedim disiplinor Of/pol/Gjyqësore. Gjatë dinamikës së punës në hetimin e çështjeve shpesh evidentojmë të meta dhe mangësi, shkelje ligjore, që janë trajtuar duke tërhequr vemendjen apo kanë mbetur thjesht ankime verbale. Për këto raste nga drejtuesi i Prokurorisë u është kërkuar Prokurorëve që të informojnë me shkrim për rastet e konstatuara dhe jo të mbetemi thjesht në ankesa të përditëshme, duke i trajtuar me frymë liberale dhe jo ligjore.

Nje problematike e evidentuar ka te beje me aktet e ekspertimit, kryesisht (kimik te bimeve) nga Policia Shkencore te cilat edhe per shkak te ngarkeses se madhe dhe mungeses se kapaciteteve njerezore, behen pengese per perfundimin ne kohe te hetimeve, konkretisht te ceshtjeve penale me te arrestuar duke shkuar deri ne limitin e afateve te paraburgimit, ku ne dy raste ky afat eshte tejkualuar.

Gjithashtu duhen evidentuar marrëdhëniet me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, në funksion të zbatimit të urdhërave dhe udhëzimeve të ardhura. Evidentojmë se nga nxjerrja e tyre kanë gjetur zbatim dhe ndikuar në mbarëvajtjen e veprimtarisë së Prokurorisë në hetimin e çështjeve dhe Përfaqësimin në gjykim.

Ka patur një bashkëpunim për tu evidentuar me Zyrën e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, në lidhje me ekzekutimin e letër-porositve me autoritetet e huaja, dhe praktikave për njohje të vendimeve penale të huaja të cilat kanë rezultuar në një numër të konsiderueshëm këtë vit, siç u përmendën më lart. Në të gjitha rastet janë kryer procedurat brenda afateve, kjo dhe për bashkëpunimin dhe ruajtjen e kontaktit në dinamikë për të gjitha rastet.

Duhet evidentuar fakti i një bashkëpunimi korrekt dhe me vlerë me Zyrën e S.P.M.T.Sh.I (Sektori i pergjimeve) në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga ana e Prokurorisë janë kërkuar dhe pranuar nga Gjykata **76-** kërkesa për pergjime ambientale, telefonike, vzhgime fotografime të cilat në pjesën me të madhe të rasteve kanë rezultuar me shumë rëndësi për çështjet, zbarrdhjen e fakteve dhe provueshmërisë së akuzave ndaj të pandehurve.

Por një problem kemi hasur në vleftësimet e pergjimeve të vënë nën pergjim në kushtet e urgjencës me autorizim nga ana e prokurorit, por në disa raste kemi konstatuar rrëzim të këtyre kërkesave nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (*3 kërkesa per vleftesimin e ligjshem te autorizimit te pergjimit ambiental*)

Pavarësisht se këto kërkesa apo vendime janë rrëzuar nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë, që të gjitha janë ankimuar për të cilat Gjykata e Apelit Shkodër na ka dhënë të drejtë. Por, këto ankimime janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit pas rreth një muaji dhe rivënia e këtyre numrave nën pergjim, sërish ka dhënë rezultat pavarësisht periudhës së madhe që ka mbatur pa u pergjuar, pasi pergjimi jep rezultat kur aplikohet në kohë reale gjatë apo direkt pas kryerjes së veprës penale.

Zëvendësimi i masave të sigurimit është bërë si i shpeshtë nga gjykata, ndërkohë që nuk ka pasur asnjë rast të ndryshimit të kushteve apo kriterëve që ka pasur parasysh gjykata në momentin e caktimit të masës së sigurimit. Por, pavarësisht faktit se në tre raste, kemi pasur zëvendësim të masave të sigurimit nga gjykata e shkallës së parë, këto masa janë ankimuar nga Prokuroria dhe Gjykata e Apelit ka vendosur sërish kthimin e tyre në burg.

ADMINISTRATA

Në mbarëvajtjen e punës të veprimtarisë së Prokurorisë, një rol të rëndësishëm kryen dhe administrata e Prokurorisë.

Rezultoni tashme një evidencë e sakte dhe e qartë që nga momenti i protokollimit të materialeve në k/sekretari, e më pas në regjistrat e regjistrimit të çështjeve, të mosfillimeve mbajtur, të pergjimeve, akzekutimeve të vendimeve penale, të përdorimit të sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, (CAMS).

Përdorimi i sistemit (CAMS) kyesisht është plotësuar, përditesuar me hedhjen e kallezimeve të ardhura në prokurori nga Zyra e Regjistratit të kësaj prokurorie, por për shkak të ngarkesës së madhe si dhe në disa raste të mungesës së kapaciteteve teknike nuk është bërë i mundur përdorimi masiv dhe sistematik nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të këtij sistemi.

Nga ana e Zyrës së financës janë evidentuar me korrektesë shpenzimet procedurale të çështjeve penale, të cilat për vitin 2016 rezultojnë në vlerë totale 6.773.000 lekë. Nga këto shpenzime për ekspertime, kontabel, autoteknike, pirroteknike, perktime e tjere, në vlerën 1.956.000 lekë.

Shpenzime procedurale në vlerën 2.450.000 leke, ndesa pjesa e mbetur shkon për pagesat e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore për orët jashtë orarit zyrtar.

Gjithashtu nga Zyra e Financës së Prokurorisë është mbajtur një evidencë e sakte për punën e kryer jashtë orarit zyrtar të punës.

Për vitin 2016 pagesa për orët mbi kohën normale të punës rezultoi në zbatim të VKM Nr. 472 datë 02/07/2011 “ Për disiplinimin e përdorimit të fondëve buxhetore për vitin 2011” si dhe të Urdhrit nr. 191 datë 27.10.2011 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për shpërblimin e gadishmerisë në prokurori” kjo pagesë bëhet vetëm kur ka ngjarje ose detyra të ngutshme si masat e sigurimit.

Ndersa per administraten nuk eshte bere asnje pagese qe sipas ligjeve te mesiperme pagesa per oret mbi kohen niormale te punes per punonjesit e administrates eshte hequr plotesisht duke i kompensuar ato me dite pushimi.

Ne kuader te zbatimit te V.K.M Nr. 591 date 23.07.2010 “ Per disiplinimin e perdorimit te fondeve buxhetore” nga ana jone po behen perpjekje per nje menaxhim sa me te kujdesshem te ketyre fondeve.

VI. DREJTIMET DHE PRIORITETET E PUNËS PËR VITIN 2017.

Sa u referuan treguesit e sipërpërmendur, në analizë të tyre, duhet të evidentojmë dhe drejtimit kryesore të punës dhe veprimtarisë për vitin në vazhdim 2017, duke përcaktuar dhe prioritetet kryesore.

Nga drejtimit duhen vlerësuar :

Së pari, një ndër drejtimit kryesore të veprimtarisë së punës për vitin 2017, është ***ngritja e cilësisë*** së hetimeve, pra e cilësisë së veprimeve hetimore të procedimeve penale. Cilësia në veprime pasqyron ***së pari ngritjen profesionale të çdo Prokurori dhe Of/Pol/Gjyqësore***, duke e pasqyruar atë në përpilimin e akteve, formulimit dhe arsyetimit ligjor të vendimeve gjatë hetimit, ato përfundimtare si dhe Përfaqësimit në Gjykatë.

Së dyti, duhet rritur ndjeshëm ***kontrolli në dinamikë*** nga ana e Prokurorëve gjatë hetimeve paraprake të çështjeve, duke mos u mjaftuar vetëm me nxjerrjen e një urdhëri për kryerje veprimesh hetimore, pritjen deri në ardhjen e akteve nga shërbimet e Pol.Gjyqësore, duke shkaktuar vonesa në hetim, humbjen e aktualitetit të një veprimi hetimore që mund të rezultojë gjatë dinamikës etj. Ne dinamikë gjatë kontrollit të veprimtarisë hetimore nga Of/pol/Gjyqësore, Prokurori duhet të jete jo vetëm një orientues i veprimeve hetimore apo të nxjerre akte proceduriale për veprime specifike si kontrole përgjime etj, por duhet të jete dhe inicues apo nxitës për një hetim sa më dinamik, të shpejtë, të një hetimi të zgjeruar për të gjitha problematikat. Duhet të evidentojë konkretisht dhe përcjellë me informacione drejtuesit të Prokurorisë apo në Prokurori të Përgjithshme problematika të veçanta, pengesa të ndryshme qofte që kanë të bëjnë dhe me mënyrën e funksionimit të organizimit të punës së veprimtarisë hetimore, siç janë zvarritjet e pajustificueshmë etj.

Së treti, për çështje të veçanta për shkak të rrezikshmërisë shoqerore apo përhapjes së një krimi duke ju referuar tendencës pra të kriminalitetit, aq më tepër për çështje të renda dhe sensitive duhet bërë ***vlerësimi i diferencuar***, kryer analiza të vlerësimit të hetimeve dhe provave të administruara, duke lënë detyra konkrete, si dhe duke kryer vetë nga Prokurorët veprime hetimore. Gjithashtu nga evidentimi i një mangësie të vitit 2016 në lidhje me kryerjen e veprimeve hetimore nga vetë Prokurorët, këtë vit duhet vlerësuar me korrektësi sidomos zbatimi i ***neni 256 të K.Pr.Penale*** në lidhje me pyetjen e të arrestuarve, apo delegimi i përfundimit të hetimeve që jo rrallë u është deleguar Of/Pol/Gjyqësore. Marrja kontakt që në momentet e para nga prokurori me të dyshuarin (arrestuarin/hetuarin/pandehurin) krijon një perceptim më të drejtë në lidhje me hetimet që do kryhen më pas, shmang dhe probleme proceduriale në lidhje me zgjedhjen e masës shtrënguese të marrë nga shërbimet e Pol/Gjyqësore, si dhe për krijimin e një politike të drejtë të kërkesës për masë sigurimi, bazuar dhe në personalitetin e të dyshuarit etj.

Në prioritetet për vitin në vazhdim 2017 :

Së pari, evidentimi, vlerësimi dhe hetimi i veprave penale të referuara apo të evidentuara kryesisht, që lidhen me veprime korruptive, të cilat kanë të bëjnë me subjekte të administratës shtetërore. Duhet nënvizuar fakti që nga ana e Prokurorëve duhet treguar vëmendje më e madhe në drejtim të vlerësimit të fakteve që rezultojnë gjatë hetimeve, për raste kur konstatohen indicie për vepra penale të karakterit korruptiv. Duhet treguar vëmendje dhe në drejtim të fakteve për të cilat ndjehet shqetësim i përgjithshëm i komunitetit.

Së dyti, kryerja e analizave të përbashkëta me seksionet dhe sektorët e shërbimeve të Policisë për veprat penale sensitive, ku duhen përmendur vjedhjet, kultivimi i bimeve narkotike si prioritete dhe të vitit të kaluar por që nuk rezultojnë rezultate, por një rritje e ndjeshme për këtë vepër penale gjatë 2016.

Së treti, Rifillimi i çështjeve të pezulluara sipas nenit 326 të K.Pr.Penale, për veprat penale të rënda siç janë vrasjet e pazbuluara, të cilat rezultojnë në një numër të konsiderueshëm të pezulluara dhe asnjë rast referimi për rifillim hetimesh.

Se katerti, duhet rritur numri i procedimeve penale të filluara kryesisht nga prokurori për veprat penale që janë sensitive për publikun.

Se pesti, Rritjen e vëmendjes së prokurorëve oficerëve të policisë gjyqësore në përdorimin e sistemit të Menaxhimit të Çështjeve.

Raportit i bashkangjishim dhe tabelat përkatëse me treguesit statistikor.

DREJTUESI I PROKURORISË

Simon PASHUKU